



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 202200775/5**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda :**            *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETITIT**  
**Tiranë**

Me shkresën nr. K2/I24-2 prot., datë 01.06.2022 ju keni vënë në dijeni se institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me nismën e vet rastin e bërë publik në media, i cili bën fjalë për një ngjarje të ndodhur gjatë përplasjes ndërmjet tifozëve të Romës dhe të Feyenoord-it në datën 25.05.2022 në qytetin e Tiranës. Gjatë kësaj përplasjeje të ultrasve italianë dhe atyre hollandezë, punonjësit e Policisë së Shtetit kanë ndaluar fotoreporterin në detyrë G.Sh., i kanë marrë me forcë aparatën fotografikë dhe i kanë kërkuar atij që të fshinte fotot e bëra gjatë përplasjes së policisë me tifozët. Sipas medias, që i referohet gazetarit Sh. i cili është drejtues i "Light Studio Agency" LSA, ai ka qenë me dokumentin e identifikimit të varur në qafë në kohën që po bënte fotografitë lidhur me skenën e ngjarjeve. Por punonjësit e policisë i kanë thënë se "nuk lejohet, po na nxin imazhin e Shqipërisë" dhe i kanë kërkuar fshirjen e këtyre fotove. Gjithashtu ai është shprehur se punonjësit e policisë i kanë kthyer aparatën fotografikë pasi ka komunikuar me zëdhënësin e Policisë së Shtetit, z. Gent Mullai, por disa foto është detyruar që t'i fshinte me pretendimin se ata dukeshin me fytyra.

Ndërkohë në media është publikuar edhe reagimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, z. Gledis Nano, i cili është shprehur se ka kërkuar hetimin e këtij rasti nga strukturat përkatëse të Drejtorisë së Standardeve Profesionale dhe Departamentit të

Sigurisë Publike. Sipas z. Nano, nëse do të konstatoheshin shkelje të procedurave standarde të punës nga punonjësit e policisë, ata do të ndëshkoheshin me masa disiplinore.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e këtij rasti i kërkuam shpjegime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kjo drejtori me shkresën nr. 682/2 prot., datë 07.07.2022 ndërmjet të tjerave na informoi se, me qëllim verifikimin, sqarimin dhe trajtimin e këtij rasti, nga Drejtoria e Standardeve Profesionale u është kërkuar informacion Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë dhe Departamentit për Sigurinë Publike.

Këto struktura kanë sqaruar se për shkak të dinamikës dhe zhvillimeve të shpejta të situatës së rendit e sigurisë publike të krijuar nga tifozeritë italiane dhe hollandeze janë angazhuar shërbimet policore të DVP Tiranë dhe FNSH-së të cilat kanë marrë masa dhe kryer veprime të shpejta për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike para dhe gjatë zhvillimit të ndeshjes finale të futbollit për Kupën e Konference Ligue, midis ekipeve AS Roma dhe Feynoord Rotterdam. Veprimet për verifikimin e rastit në fjalë vazhdojnë me qëllim për të bërë të mundur identifikimin e punonjësit të policisë që ka kryer veprimet ndaj fotoreporterit në detyrë G.Sh.. Ndërkohë strukturat vendore të policisë kanë marrë detyrë për ndjekjen e mëtejshme të këtij rasti.

Sikurse rezulton nga kjo përgjigje, rasti në fjalë është në verifikim nga strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit. Por ndonëse kanë kaluar disa muaj nga ndodhja e kësaj ngjarjeje, në vijim nuk na është dërguar asnjë informacion mbi rezultatet e hetimit administrativ të këtij rasti.

Ne vlerësojmë se ndjekja e rastit në fjalë nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit nuk është bërë me seriozitetin e duhur. Këto struktura i kanë kapacitet e duhura njerëzore e teknike që të bëjnë të mundur identifikimin e punonjësit të policisë që i ka marrë aparatën fotografik gazetarit G. Sh. dhe e ka detyruar atë që të fshijë disa nga fotot e realizuara prej tij. Për më tepër veprimet e ndodhura në ngjarjen në fjalë janë të filmuara e bërë publike në disa kanale televizive si dhe nga kamerat e bizneseve private që ndodhen në zonën ku u zhvilluan ato.

Në këtë përfundim arrijmë duke u nisur edhe nga analizimi i disa rasteve të tjera të ngjashme, në të cilat punonjësit e policisë janë sjellë në mënyrë jokorrekte dhe pa etikë me gazetarët gjatë komunikimeve në ngjarje të ndryshme ku janë të pranishëm punonjësit e medias. Ndër këto mund të përmendim:

- Rastin e bërë publik në median online, “Lapsi.al”, në datën 06.01.2022. Kjo media ka botuar artikullin me titull: *“Teksa duhej të ndalonin persona të rrezikshëm e banditë që lëvizin e bëjnë “ligjin” në Shkodër, RENE A, ka harruar sonte misionin e saj dhe të gjithë “forcën” e ka treguar ndaj gazetarit të ABC, S.Sh. i cili po filmonte aksionin”*.

Në këtë artikull shkruhet se në sy të dy fëmijëve të tij, trupat e RENE A-s kanë dhunuar korrespondentin e ABC në Shkodër edhe pse ky i fundit u ka treguar atyre dokumentin e

gazetarit dhe se ishte në detyrë. Ai ju ka thënë atyre se: “Jam gazetar, jam në punë, ja ku e kam “badgen””. Këto fjalë nuk kanë mjaftuar për “trup mëdhenjtë” e RENEA-s të cilët duke dhunuar gazetarin i kanë marrë edhe “badgen” identifikues si punonjës i medias.

Nga përgjigjja e dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër me shkresën nr. 380/2 prot., datë 19.01.2022 ndërmjet të tjerave u informuam se, nuk rezulton që ndaj gazetarit të jetë ushtruar dhunë, sikurse pretendon ai, pasi nga punonjësit e policisë janë zbatuar rregullat e parashikuara në Procedurën Standarde të Punës “Për ngritjen dhe funksionimin e pikave të kontrollit”, miratuar me urdhrin nr. 621, datë 07.06.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Procedurën Standarde të Punës “Për ndalimin dhe kontrollin e automjeteve në rrugë”, miratuar me urdhrin nr. 760, datë 14.07.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 278/1 prot., datë 20.01.2022 na informoi se, lidhur me këtë rast të bërë publik në media në datën 06.01.2022, çështja është duke u analizuar nga strukturat përkatëse dhe do të merren masat e nevojshme sipas ligjit dhe Procedurave Standarde. Në vijim me shkresën nr. 278/3 prot., datë 09.06.2022 ndërmjet të tjerave na informoi se, ndaj punonjësve të policisë efektivë të Repartit Special “RENEA” ka filluar ecuria disiplinore. Në përfundim është konkluduar që ndaj këtyre punonjësve të jepet masa disiplinore “Tërheqje vëmendje”, parashikuar nga neni 237/3 e Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 19.05.2015, të ndryshuar. Kjo masë “Tërheqje vëmendje”, referuar nenit 237/3<sup>1</sup> të Rregullores së Policisë së Shtetit është masë parandaluese dhe jo masë disiplinore që mund t’u jepet punonjësve të policisë. Por ajo që është më e rëndësishme në këtë rast qëndron në faktin se strukturat drejtuese janë mjaftuar me kaq dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë lloj angazhimi për trajnimin e punonjësve të policisë dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla në atë ardhmen.

- Një rast tjetër është ai i gazetarit të TV “Fax News”, B.B., i cili në datën 9 mars 2020, rreth orës 23:25 ka shkuar pranë mjediseve të Ministrisë së Brendshme, për të monitoruar një tubim që po zhvillohej nga disa qytetarë në mbështetje të shtetasit turk, S.S.. Shtetasi i huaj, ndonëse atë ditë kishte fituar lirinë nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe pavarësisht kërkesës së tij për azil, po mbahej në një furgon policie duke pritur vendimin e dëbimit nga autoritetet shqiptare.

---

<sup>1</sup> **Neni 237 “Masat parandaluese dhe disiplinore për punonjësit e policisë” parashikon se:**

1. Me masa parandaluese kuptojmë të gjitha ato veprime që kryhen nga drejtuesit e të gjitha niveleve me synim korrigjimin e mangësive të konstatuara gjatë veprimtarisë së përditshme të punonjësit të Policisë, pa përdorur procesin e ecurisë disiplinore.

2. Masat parandaluese mund të jepen para fillimit të ecurisë disiplinore ose në rastet kur, pas verifikimit të shkeljes së konstatuar, eprori argumenton me shkrim arsyet e mosndëshkimit të personit me masë disiplinore.

3. Masat parandaluese janë masat “Këshillim” dhe “Tërheqje vëmendje”.

4. Në rastet kur punonjësi ndëshkohet me masë disiplinore, për shkelje të lehta disiplinore, ndaj tij jepen masat “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim” dhe për shkelje të rëndë disiplinore me masat “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet”, “ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj” ose “përrjashtim nga Policia”.

Punonjësi i medias duke qenë në krye të detyrës, është shoqëruar në mënyrë të padrejtë nga punonjësit e policisë si person i dyshuar si autor i veprës penale dhe është marrë në pyetje nga strukturat e antiterrorit.

Gjatë shqyrtimit të këtij rasti ndërmjet të tjerave ne konstatuam se nga punonjësit e policisë Eduard Prenga dhe Ermal Deliu me detyrë Specialistë të Njësisë Rajonale të Antiterrorit Tiranë të cilët kishin kryer veprime me të shoqëruarin, nuk ishte përpiluar dhe dhënë ankuesit një kopje e procesverbalit për veprimet e kryera me personin e shoqëruar, sikurse parashikohet në nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe në Kreun VII, pika 1, gërma “f” të Procedurës standarde të punës. Ndonëse kjo shkelje sipas nenit 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe Kreut VII-të, pika 1, gërma “f” dhe Kreut të VIII-të, pikat a.3.3 dhe a.3.4 të Procedurës standarde të punës, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përbën shkelje të rëndë, punonjësit e policisë nuk u ndëshkuan me masë disiplinore, por iu dha masa parandaluese “Tërheqje vëmendje”.

- Po ashtu, mund të përmendim rastet e shoqërimit në organet e policisë të disa gazetarëve gjatë protestave të organizuara gjatë muajit dhjetor 2020 pas vrasjes së të ndjerit Klodian Rasha, si gazetarit të “RTV Ora”, Xh.M., të Kryeredaktorit të gazetës “Koha Jonë”, Q.Xh., të gazetarit të “Syri TV” në Durrës, A.M., si edhe punonjësit të medias “Durrës Lajm”, Sh.D., të cilat i kemi referuar në Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë e Durrës.

Shoqërimi dhe dhuna ndaj kryeredaktorit të gazetës “Koha Jonë”, Q.Xh. nga forcat speciale të Policisë së Shtetit, është dënuar edhe nga Komisioni Europian. Zëdhënësja për çështjet e zgjerimit dhe fqinjësisë së BE-së, Ana Pisonero përmes një qëndrimi për “Euroneës Albania”, thekson se kërcënimi dhe intimidimi i gazetarëve është i papranueshëm.

*“Paketa e Zgjerimit për 2020 tregon qartazi nevojën për të pasur zero tolerancë ndaj frikësimeve dhe kërcënimeve kundrejt gazetarëve dhe medias në rajon. Është thelbësore që gazetarët në Shqipëri të jenë të aftë ta bëjnë punën e tyre pa qenë të kërcënuar nga dhuna, sulmet apo intimidimet, për të siguruar që qytetarët kanë akses ndaj informacionit”,* thuhet në reagimin e KE.<sup>2</sup>

Qëndrim publik lidhur me përshkallëzimin e situatës në dhjetor 2020, ka mbajtur edhe Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic, e cila ndër të tjera është shprehur se: *“Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmbajtje në menaxhimin policor të demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e përdorimit të tepruar të forcës. Ndërsa e drejta për mbledhje paqësore mund të kufizohet për të mbrojtur shëndetin publik, autoritetet*

---

<sup>2</sup>Shih <https://www.alb365.al/v1/2020/12/14/ke-demon-dhunen-ndaj-gazetareve-jo-sulme-dhe-intimidime/?fbclid=IëAR2IC7e3yYkZMËSVOVp95Z7jz5jYYBsmkB10NCEe-JCVv2J4A-vhGBJeiT8>

*duhet të mbështesin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në të gjitha rrethanat. Policia gjithashtu duhet të bëjë dallimin midis individëve të përfshirë në dhunë dhe atyre që demonstrojnë në mënyrë paqësore dhe të përmbahen nga përdorimi i rëndë ose pa kriter i forcës.”<sup>3</sup>*

Gjithashtu, Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se është i shqetësuar në lidhje me ndalimin dhe sulmet e pretenduara ndaj disa gazetarëve që mbulojnë demonstratat.

Sipas zj. Mijatovic, “...sulmet ndaj gazetarëve përbëjnë një shkelje serioze të lirisë së shtypit dhe të drejtës për tu informuar. Autoritetet duhet të sigurojnë që gazetarët mund të vazhdojnë të informojnë qytetarët pa frikë nga kërcënimet ose aktet e dhunës ”.

Avokati i Popullit vlerëson se dhuna ndaj gazetarëve, fizike apo psikologjike, rrezikon të drejtat për integritet personal, jetën dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes. Po kështu, mungesa e kujdesit të duhur në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e të gjithë personave apo strukturave që janë përgjegjës, mund të rezultojë në një shkelje shtesë të të drejtave për akses në drejtësi dhe garancitë gjyqësore të të prekurve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Në lidhje me dhunën apo edhe tejkalimin e forcës ndaj gazetarëve dhe personave të tjerë bazuar në ushtrimin e lirisë së shprehjes, Zyra e Raportuesit Special ka theksuar rëndësinë e tre detyrimeve pozitive që burojnë nga të drejtat për jetën, integritetin personal dhe lirinë e shprehjes. Konkretisht, detyrimi për të parandaluar, detyrimi për të mbrojtur dhe detyrimi për të hetuar, provuar dhe ndëshkuar penalisht ata që janë përgjegjës për këto krime.<sup>4</sup> Siç ka treguar Zyra e Raportuesit Special, këto detyrime janë plotësuere të njëra-tjetrës: në mënyrë që të jetë e lirë, e fortë dhe të ekzistojë debati i pakufizuar demokratik, dhuna ndaj gazetarëve duhet të luftohet përmes një politike gjithëpërfshirëse të parandalimit, mbrojtjes dhe ofrimit të drejtësisë.

Zyra e Raportuesit Special ka theksuar në vijimësi përgjegjësinë e zyrtarëve qeveritarë për të mbajtur vazhdimisht qëndrime publike që nuk i vënë gazetarët në rrezik të rritur të dhunës. Zyra e Raportuesit Special ka kujtuar, ndër të tjera, se masa e thjeshtë, por shumë efektive mbrojtëse përbëhet nga qëndrimet e autoriteteve më të larta të shtetit që njohin në mënyrë të qëndrueshme, të qartë, publike dhe të vendosur legjitimitetin dhe vlerën e

---

<sup>3</sup> Për më tepër, mund të shihet Deklarata e plotë e datës 16.12.2020 “*Albanian authorities must prevent further police violence and uphold the right to freedom of peaceful assembly*”.  
<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly>

<sup>4</sup> United Nations (UN) Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples’ Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information. June 25, 2012. *Joint Declaration on Crimes Against Freedom of Expression*.

profesionit të gazetarit, edhe kur informacioni i shpërndarë mund të rezultojë kritik ose i papërshtatshëm për interesat e qeverisë. Në mënyrë të ngjashme, është thelbësore që autoritetet të dënojnë me forcë sulmet e kryera kundër punonjësve të medias dhe inkurajojnë autoritetet kompetente të veprojnë me rigorozitet dhe shpejtësi për të hetuar ngjarje të tilla dhe për të ndëshkuar përgjegjësit e tyre.<sup>5</sup>

Sulmet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias përbëjnë shkelje veçanërisht serioze të të drejtave të njeriut sepse ato synojnë jo vetëm individët, por privojnë të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacion, duke kufizuar kështu debatin publik, i cili është në zemër të demokracisë pluraliste. Në përgjigje të nivelit alarmant dhe të papranueshëm të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias në Evropë, dhe duke pasur parasysh efektin dëmtues në funksionimin e shoqërisë demokratike, në Prill 2016, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin CM/Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.<sup>6</sup>

Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh natyrën specifike dhe vlerën demokratike të rolit të luajtur nga gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias, të tilla si në kohë krize, gjatë periudhave të zgjedhjeve, në demonstrata publike dhe në zona konflikti. Në veçanti, në këto kontekste është e rëndësishme që autoritetet e zbatimit të ligjit të respektojnë rolin e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias që mbulojnë protesta dhe ngjarje të tjera. Kartat e shtypit, akreditimi përkatës dhe shenjat e gazetarëve duhet të pranohen nga autoritetet shtetërore si letra kredenciale. Kur nuk është e mundur që gazetarët ose aktorët e tjerë të medias të prodhojnë dokumentacion profesional, autoritetet shtetërore duhet të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të përcaktuar statusin e tyre. Dialogu midis autoriteteve shtetërore dhe organizatave të gazetarëve inkurajohet për më tepër për të shmangur fërkimet ose përplasjet midis policisë dhe punonjësve të medias.

Në çështjen *Pentikäinen kundër Finlandës*, Gjykata nënvizoi rolin thelbësor të mediave në sigurimin e informacionit mbi trajtimin e tubimeve publike nga autoritetet dhe ndalimin e çrregullimeve. Duke theksuar funksionin “*vëzhgues*” të mediave, gjykata deklaroi se çdo përpjekje për të hequr gazetarët nga skena e demonstratave duhet t’i nënshtrohet një kontrolli të rreptë.

Sipas qasjes së Gjykatës, çdo situatë e tillë duhet të shihet në dritën e rrethanave të secilës çështje të veçantë. Elementet që do të merren në konsideratë nga gjykatat kombëtare përfshijnë: (a) nëse autoritetet kishin parandaluar ose penguar qëllimisht mediat nga mbulimi i ngjarjes në një përpjekje për të fshehur nga vështrimi publik veprimet e policisë/organeve të tjera publike; (b) nëse bindja ndaj urdhrave të autoriteteve do të kishte

---

<sup>5</sup> Annual Report 2010. Office of the Special Rapporteur for Freedom of Expression.

<sup>6</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar në mënyrë të përsëritur që individë, organizata të shoqërisë civile, sinjalizues dhe akademikë, përveç gazetarëve profesionistë dhe medias, të gjithë mund të japin kontribute të vlefshme në debatin publik, duke luajtur kështu një rol të ngjashëm ose ekuivalent me atë të luajtur tradicionalisht nga media e institucionalizuar dhe gazetarët profesionistë.

penguar plotësisht përfaqësuesit e mediave të kryejnë detyrat e tyre profesionale. Gjykata, megjithatë, gjithashtu deklaroi se gazetarët duhet t'i binden urdhrave të ligjshëm të policisë dhe nuk mund të kërkojnë imunitet nga përgjegjësia penale për arsyen e vetme që vepra penale (nëse ka) ishte kryer gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gazetareske.<sup>7</sup>

Duke pasur parasysh rolin thelbësor të gazetarëve në përcjelljen e informacionit për publikun dhe mbajtjen e përgjegjësisë nga autoritetet, veçanërisht në kontekste të ndjeshme, është e domosdoshme që autoritetet shtetërore të mos ndërhyjnë në mbulimin nga ana e medias të ngjarjeve që kanë implikime të rëndësishme për funksionimin e sistemeve demokratike. Si rrjedhojë, gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias kanë të drejtë të fotografojnë, duke përfshirë trajtimin policor të trazirave dhe se pajisjet e tyre nuk duhet të sekuestrohen.

Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të jenë të vëmendshme ndaj shenjave dhe kredencialeve të gazetarëve. Mungesa e tyre nuk duhet të përdoret si pretekst për kufizime të padrejta në aktivitetet gazetareske. Kur gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias nuk janë në gjendje të prodhojnë dokumentacion që tregon statusin e tyre, autoritetet duhet të përpiqen ta verifikojnë atë me mjete të tjera, për shembull, duke konsultuar organizata të besueshme mediatike dhe organizata profesionale të gazetarëve që mund të konfirmojnë statusin e gazetarit. Trajnimi/dialogu i koordinuar midis medias dhe policisë është i rëndësishëm për të kuptuar përgjegjësitë dhe kufizimet e njëri-tjetrit dhe për këtë arsye sigurojnë besim dhe marrëdhënie të mira pune.

Ish-Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut Nils Muiznieks ka theksuar se dhuna e policisë ndaj gazetarëve, veçanërisht kur mbulojnë demonstratat, është ndër kërcënimet më të përhapura ndaj lirisë së medias. Për shembull, në vitin 2013 më shumë se gjysma e të gjitha rasteve të gazetarëve të plagosur përfshinin lëndime të shkaktuara nga policia.<sup>8</sup> Raporti special i Hartësimit të Lirisë së Medias 2018 nga Indeksi i Censurës gjithashtu thekson që anëtarët e forcave të zbatimit të ligjit janë përgjegjës për më shumë se gjysmën e incidenteve kundër medias gjatë protestave të raportuara në shtatë muajt e parë të vitit 2018 në Evropë.<sup>9</sup> Kjo dëshmon qartë një nevojë urgjente për përmirësime në trajtimin policor të mediave që mbulojnë demonstratat.

Në çështjen *Najafli kundër Azerbajxhanit*<sup>10</sup> u trajtua rasti i një gazetari të rrahur nga policia ndërsa mbulonte një protestë të paautorizuar. Megjithëse gazetari nuk kishte veshur një jelek blu që e identifikonte atë si anëtar të shtypit, ai kishte veshur një simbol

---

<sup>7</sup> Shif *Pentikäinen v. Finland* (GC), nr. 11882/10, 20 Tetor 2015, §§ 89, 91.

<sup>8</sup> Shih Deklaratën e dhënë nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut Nils Muiznieks në Seminarin mbi mbrojtjen e gazetarëve në KEDNJ në nëntor 2014.

<sup>9</sup> *Demonising the Media: Threats to journalists in Europe*, Index on Censorship, Special report, November 2019, fq 8.

<sup>10</sup> *Najafli v. Azerbaijan*, nr. 2594/07, 2 Tetor 2012.

dhe kishte deklaruar vazhdimisht se ishte gazetar. Gjykata jo vetëm që gjeti shkelje të Nenit 3 për shkak të keqtrajtimit, por edhe një shkelje të Nenit 10 të Konventës. Gjykata deklaroi se përdorimi i forcës së tepruar ndaj gazetarëve ndërsa ata ishin duke kryer detyrat e tyre profesionale, seriozisht pengon ushtrimin e tyre të së drejtës për të marrë dhe për të dhënë informacion, pavarësisht nëse kishte ndonjë qëllim nga ana e policisë për të ndërhyrë në aktivitetin e tyre.

Shqetësimi mbi intimidimin e gazetarëve dhe dhunën e ushtruar ndaj tyre është bërë prezent edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë<sup>11</sup> për vitin 2022. Më konkretisht në këtë raport thuhet se, në përgjithësi, atmosfera e sulmeve verbale, fushatat e shpifjeve dhe aktet e frikësimit ndaj gazetarëve nuk janë përmirësuar.

Në të gjitha rastet e analizuara më lart, kemi konstatuar se në momentin e pengimit apo shoqërimit, punonjësit e medias kanë qenë duke ushtruar detyrën e tyre si gazetarë, si dhe të drejtës së garantuar nga ligji nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”<sup>12</sup>. Kjo ka sjellë si pasojë edhe pengimin e tyre për të ushtruar profesionin e gazetarit, i cili është i garantuar me ligj. Është rasti t’ju sjellim në vëmendje se këtë shqetësim e kemi trajtuar edhe më parë dhe konkretisht në rekomandimin drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile me shkresën nr. K2/I18-4 prot., datë 21.07.2020. Ku më specifikisht kemi rekomanduar: “*Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.*”

Vlerësojmë se raste të tilla të cilat janë në kundërshtim të hapur dhe të plotë me aktet normative në fuqi nuk duhet të kalojnë pa u analizuar në mënyrë të thellë, pa nxjerrë përgjegjësitë ndaj punonjësve që kanë kryer shkeljet ligjore, pa ndëshkimin e tyre dhe pa caktuar detyrat konkrete e masat e nevojshme për përmirësimin e punës në të ardhmen. Strukturat drejtuese vendore dhe ato të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sapo informohen nga institucioni ynë, media apo burime të tjera, duhet të veprojnë menjëherë për të marrë masat e nevojshme. Kalimi në heshtje apo me masa parandaluese i rasteve të tilla, jo me ndjeshmërinë e duhur, është jo vetëm i dëmshëm por edhe me pasoja për të ardhmen për shkak të përsëritjes së këtij fenomeni. Këto shkelje të ligjit nuk cenojnë vetëm të drejtat ligjore të gazetarëve, por në të njëjtën kohë dëmtojnë edhe imazhin dhe reputacionin e Policisë së Shtetit në publik.

---

<sup>11</sup> Për më tepër shih linkun si vijon:

[https://ec.europa.eu/info/departments/european-neighbourhood-policy-and-enlargement-negotiations\\_en](https://ec.europa.eu/info/departments/european-neighbourhood-policy-and-enlargement-negotiations_en)

<sup>12</sup> **Neni 4 “Prania e medias” parashikon se:**

*1. Përfaqësuesit e medias kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë tubimit dhe nuk mund të përjashtohen nga askush gjatë zhvillimit të tij.*

*2. Përfaqësuesit e medias duhet të jenë të pajisur me kartën e anëtarësisë së medias.*

*3. Prania e përfaqësuesve të medias gjatë tubimit u bëhet e ditur në çdo kohë forcave të policisë që ndjekin zhvillimin e tubimit.*

**Neni 13 “Personat që ndjekin tubimin” parashikon se:**

*Drejtuasi i tubimit dhe organizatorët e tij vendosin se cilët persona do të ndjekin tubimin, përveç përfaqësuesve të medias të cilët, në asnjë rast, nuk mund të përjashtohen.*



Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi më të fortë nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve në detyrë, si gjatë zhvillimit të tubimeve të ndryshme ashtu edhe në rastet kur ata janë të pranishëm gjatë kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit në mjedise publike në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të analizuar në mënyrë të thellë, me objektivitet dhe me profesionalizëm shkaqet e rasteve të sjelljes pa etikë të punonjësve të policisë ndaj gazetarëve.
3. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat vendore e qendrore të Policisë së Shtetit për trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë me qëllim që të lejojnë gazetarët të kryejnë profesionin dhe misionin e tyre dhe të sillen me etikë gjatë komunikimit me ta.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit për ndëshkimin e punonjësve të policisë që kryejnë shkelje me gazetarët dhe punonjësit e medias me masa disiplinore në mënyrë proporcionale me shkeljet e kryera.
5. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtyre rasteve në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**